



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 03-III/01-26245
Datë: 27.08.2025

**DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE**

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Asistent/e i Stomatologjisë në QKMF-Lipjan

Detyrat dhe përgjegjësitë për Asistent të Stomatologjisë:

1. Është përgjegjës në mënyrë të drejt dhe racional të gjitha llojet e materialeve dhe medikamenteve stomatologjike.
2. Është përgjegjës për regjistrimin e të dhënave të pacientit në protokollin shëndetësor dhe në sistemin informativ shëndetësor (SISH) dhe përgatit pacientin nga ana psikologjike për të gjitha intervenimet stomatologjike.
3. Përgatit për punë ordinancën stomatologjike dhe përdor metodat e asepsës dhe antiaepsës (dezinfekton, sterilizon instrumentet dhe materialet stomatologjike).
4. Bën planifikimin e materialit medikamenteve të nevojshme për punë.
5. Zbaton kodin e veshjes dhe sjelljes profesionale dhe ruajtjen e të drejtave të pacientit duke zbatuar kodin e etiko-profesionale.
6. Zbaton të gjitha rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtje të mjedisit.
7. Përgatit me shkrim raportet mujore për shpenzimet të barnave dhe materialit për eprorin tij/saj dhe raporton për shërbimet e tij/saj organit përgjegjës-shefit të stomatologjisë ose Drejtorit të QKMF-së.
8. Kryen edhe punë të tjera nga profesioni i tij/saj me kërkesën e eprorit të drejtpërdrejt ose të Drejtorit të QKMF-së.

Kushtet dhe kriteret:

- Shkolla e Mesme e Mjekësisë-Drejtimi Asistent i Stomatologjisë
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore
- Rezumeja personale (CV)
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkuara më lartë
- Të ketë shkathësi dhe kualitete personale.

Paga mujore:

Grupi H klasa H20 **Koeficienti:5.6**

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të përcaktuar

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data **27.05/2025** deri me **26.06/2025** që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur(nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

**Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini**

